

VENDIM
Nr. 59, datë 15.4.2019

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “S G D ENERGJI”
SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“NDËRFUSHAS”, ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 1125 kw**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.4.2019, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “S G D Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurave për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Shoqëria “S G D Energji”, sh.p.k., me shkresën nr. 250 prot., datë 27.4.2019, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ndërfushas”, me fuqi totale të instaluar 1125 kw.

Aplikimi i shoqërisë “S G D Energji” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, dhe “c” “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”; 4.1.4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”; 4.1.5, gjerat “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Shoqëria “S G D Energji” sh.p.k. ka lidhur kontratën me nr.2728 rep.; nr. 1293/1 kol., datë 6.11.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Ndërfushas”, me kapacitet prodhues 1125 kw, në rrjedhën e mesme të përroit të Sharrës dhe përroit të Zhavoreve, degë e përroit të Lenës, degë e lumit Mat, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër, për një afat 49-vjeçar (dyzetentëvjeçar). ERE në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- nenin 9, pika 2, germa “d” (vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria) dhe germa “c” (struktura e ndërtimit të shoqërisë). Lista e personelit sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca);
 - nenin 9, pika 3 germa “b” (paraqitje e bilancit financiar të tri viteve të fundit); dhe
 - nenin 9, pika 4.1.5, germa “a” (miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “S G D Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ndërfushas”, me fuqi totale të instaluar 1125 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti